



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja Nr. 27
Prishtinë, më 17.06.2009
Salla N-225 ora 10,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Memli Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi, Heset Cakolli Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë: Lule Ymeri.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i UNDP-së, OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.**
- 3. Diskutim rreth vizitave të Komisionit në Drejtoritë Komunale të Arsimit**
- 4. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe propozoi që të debatohet lidhur me rendin e ditës.

Arsim Rexhepi propozoi që në rend dite të shqyrtohet dhe të debatohet lidhur me çështjen e mbarëvajtjes së provimit shtetëror të maturës pasi që nga rezultatet e publikuara ne mjetet e informimit shifrat e kalueshmërisë janë shqetësuese dhe janë vërejtur disa parregullsi në disa komuna.

Për këtë çështje propozon një takim me përfaqësues të Ministrisë.

Adem Hajdaraj mendon se lidhur me këtë çështje duhet debatuar pasi ti kemi informacionet e sakta nga përfaqësuesit e ministrisë.

Enis Kervan përkrah mendimet e parafolësve, me qëllim të debatimit lidhur me këtë çështje duhen informata më të sakta nga përfaqësuesit e ministrisë. Sa i përket testit të maturës në gjuhën turke ai mendon se ekzistojnë ca probleme edhe në testin e gjuhës turke si dhe në përgjithësi me testet shkollore në gjuhën turke.

Heset Cakolli tha se çështja e provimit të maturës shtetërore është një çështje shumë e njeshme që don një trajtim të veçantë lidhur me këtë përkrah idenë që në një mbledhje të ardhshme të ftohet kryetari i Komisionit Shtetëror të Maturës.

Kryetari i Komisionit, konstatoi se me qëllim të informimit të Komisionit me rrjedhën e testit të maturës shtetërore në mbledhjen e radhës të ftohet Kryetari i Komisionit Shtetëror të Maturës Nehat Mustafa.

Komisioni u pajtua që në mbledhjen e cila do të mbahet me 24.6.2009 në orën 10,00 të debatohet lidhur me ecurinë e provimit të maturës shtetërore ku do të ftohet Kryetari i Komisionit Shtetëror të Maturës Nehat Mustafa.

Pasi nuk kishte propozime tjera, kryetari propozoi të vazhdohet me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 25.05.2009.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me ecurinë e punëve rreth shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Kjo mbledhje e Komisionit i paraprin dëgjimit publik që do të mbahet më datë 19.6.2009 në Hotel Grand në Prishtinë që mbështetet nga NDI.

Komisioni ka marrë disa rekomandime nga dëgjimi publik i mbajtur për këtë Projektligj më datë 3.6.2009 nga përfaqësuesit e Grupit joformal të rinjëve të cilat do ti shqyrtojë. Lidhur me këtë projektligj është caktuar raportues Arsim Rexhepi.

Arhim Rexhepi propozoi që lista e të ftuarve për dëgjimin publik të organizuar nga NDI të plotësohet me përfaqësues të organizatave rinore nga qytetet që nuk janë përfshirë në këtë listë si Gjakova, Ferizaj, Podujeva dhe Skenderaj.

Enis Kervan propozoi që rekomandimet nga Grupi joformal i të rinjëve të merren parasysh nga Komisioni gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të Projektligjit. Ai mendon se listës së të ftuarve për dëgjim publik ti shtohen edhe drejtorët e Departamenteve të Rinisë të komunave të Kosovës.

Memli Krasniqi propozon që kësaj liste ti shtohen përfaqësuesit e Organizatave Rinore që përfaqësojnë komunitetet, përfaqësuesit e Forumeve rinore të partive politike, dhe Organizatat e ndryshme rinore jopolitike.

Drita Kadriu kërkoi sqarim lidhur me organizimin të dëgjimit publik nga përfaqësuesit e Grupit joformal të të rinjëve, pse nuk është ftuar Komisioni.

Enis Kervan njoftoi Komisionin se këtë dëgjim publik e ka organizuar Grupit joformal i të rinjëve me përkrahje të OSBE-së në të cilin ka marrë pjesë si deputet i të rinjëve e jo si anëtar i Komisionit.

Kryetari tha se Komisioni për këtë Projektligj, me 19 qershor 2009, në orën 10,00 do të organizojë dëgjim publik, ku si pjesëmarrës do të ftohen edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Grupi joformal i deputetëve të rinj të Kuvendit të Kosovës, të drejtorive komunale për rini, organizatës rinore të komuniteteve, forumet rinore partiake, organizatat joqeveritare që merren me çështjet e rinisë, si dhe subjektët tjerë të cilët në mënyrë direkte apo jodirekte janë të lidhur me çështjet e rinisë në tërësi. Lista e të ftuarve për Dëgjim Publik duhet të plotësohet me kërkesat e anëtarëve të Komisionit.

Të ftohen edhe përfaqësues të organizatave rinore nga qytetet që nuk janë përfshirë në këtë listë si Gjakova, Ferizaj, Podujeva dhe Skenderaj, drejtorët e Drejtorateve të Komunave apo zyrtarët, përfaqësuesit e Organizatave Rinore që përfaqësojnë komunitetet, përfaqësuesit e forumeve rinore të partive politike, dhe organizatat e ndryshme rinore jopolitike.

3. Diskutim rreth vizitave të Komisionit në Drejtoritë Komunale të Arsimit

Kryetari lidhur me këtë pikë tha se Komisioni ka filluar me vizitat nëpër komuna dhe ka përpiluar një agjendë me grupe të caktuara të anëtarëve të Komisionit.

Grupet e caktuara të anëtarëve të Komisionit do të vizitojnë Drejtoratet Komunale të Arsimit ku do të njihen për afërsisht me zbatimin e ligjeve në fuqi.

Anëtarët e Komisionit Drita Kadriu, Arhim Rexhepi dhe Memli Krasniqi të hënën më 22.6.2009 do të vizitojnë DKA në Vushtri dhe në DKA Mitrovicë.

4. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit Arhim Rexhepi, Gani Buçinca, Memli Krasniqi kërkuan që zyrtarët e Zyres për informim të Kuvendit të prezantojnë dhe të përcjellin rregullisht mbledhjet e Komisionit për arsim.

Kryetari lidhur me këtë kërkesë të anëtarëve të Komisionit, kërkoi që ti dërgohet shkresë Zyrës për informim të Kuvendit në mënyrë që puna e këtij Komisioni të përcillet dhe të paraqitet në Web faqen e Kuvendit.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të mbahet me 24.6.2009 në orën 10,00 ku do të ftohet Kryetari i Komisionit Shtetëror të Maturës Nehat Mustafa që të informojë Komisionin lidhur me ecurinë e provimit të maturës shtetërore.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11, 10

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu